



Kolegji Riinvest
Zyra për planifikim akademik

Matematikë për Biznes EKB0008

Mësimdhënësit e Lëndës:	Mergim Pervetica
Mësimdhënësit e Lëndës:	Lindita Vrajolli

Hyrje

Matematika si lëmi shkencore gjenë zbatim të gjërë në të gjitha shkencat tjera, si natyrore ashtu edhe shoqërore. Në këtë kurs do të mundohemi që studentit ti japim njohuri bazike si dhe ide si të zbatohen ato njohuri në probleme ekonomike dhe te biznesit.

Qëllimet

Lënda e matematikës i aftëson studentët me njohuri bazike nga Matematika e Biznesit dhe i përgatit të njëjtit për të zbatuar atë në problemet e Inxhinierisë dhe të Biznesit si dhe është bazë për përvetësimin e lëndëve të tjera të parapara në plan-programin e Studimeve Bazike dhe atyre post-diplomike

Rezultatet e pritura të lëndës

- Njohë kuptimet dhe rezultatet themelore lidhur me funksionet (sidomos ato lineare), Derivatet e rendit të parë e të dytë, Disa kuptime themelore ne probabilitet
- Zbatojë konceptet e mësuara matematikor në biznes
- Të zgjidh probleme të ndryshme teorike e praktike nga Ekonomiksi dhe Biznesi

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Bashkësitë	Nocioni dhe përkufizimi i bashkësive, Veprimet themelore me bashkësi dhe aplikimi i tyre. Bashkësit numerike.
2	Aritmetikë	Mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi me numra të plot. Kllapëzimet, thyesat (mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi), Numrat decimal, Përqindjet, Fuqizimi dhe rrënjët katrore.
3	Algjebra	Rregullat Algjebrike: Mbledhja, Zbritja, Shumëzimi dhe Pjesëtimi i shprehjeve algjebrike, Faktorizimi dhe thjeshtëzimi i shprehjeve algjebrike
4	Barazimet dhe jobarazimet lineare me një variabël	Zgjidhja e barazimeve (ekuacioneve) dhe jobarazimeve (inekuacioneve), aplikimi në biznes
5	Funksionet lineare	Paraqitja grafike e funksioneve lineare, Zgjidhja algjebrike dhe grafike, Aplikimi në biznes (Ekuilibrimi i tregut).

6	Sistemet e ekuacioneve lineare me dy të panjohura	Zgjidhja e sistemeve të ekuacioneve dhe inekuacioneve lineare me dy të panjohura, aplikimi në biznes, Dorezimi i detyrave shtëpiake, Testi i parë periodik
7	Ekuacioni kuadratik	Zgjidhja e ekuacionit kuadratik, Formula kuadratike, zbatim në biznes
8	Funksioni kuadratik	Paraqitja dhe zgjidhja grafike, Aplikimi në biznes dhe ekonomi (Pika rentabile)
9	Vargjet dhe Shumat	Vargjet dhe Shumat, llojet kryesore që gjejnë zbatim në biznes (aritmetik dhe gjeometrik)
10	Perqindjet dhe matematika financiare	Llogaritja e përqindjeve, interesi i thjeshtë dhe i përbër, kredit
11	Derivati i funksionit dhe rregullat kryesore	Disa rregulla kryesore për derivimin e funksioneve që më së shpeshti përdoren në ekonomi dhe biznes
12	Zbatimi i derivati i funksionit në biznes dhe në analizim të funksioneve	Zbatimi i derivati i funksionit në biznes, funksioni i te hyrave dhe kostos dhe funksionet përkatëse marginale, Shqyrtimi i funksionit nëpër pika

Informata shtesë 1:

Lënda ju referohet shembujve praktik nga ekonomia dhe biznesi të cilët kanë për qëllim të vënë në pah ndërlidhjen direkte në mes të anës teorike dhe asaj praktike të Matematikës për Biznes.

Informata shtesë 2:

Zgjidhja e detyrave dhe problemeve në tabelë, slide e publikuara në e-learning etj.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Detyra	10		Studentët do të bëjnë detyra çdo javë në shtëpi si dhe do të dorëzojnë ushtrimet në klasë të cilat do të vlerësohen dhe notohen. Studentët mbajnë vet përgjegjësinë të marrin detyrat në rast mungesës dhe t'i dorëzojnë ato. Data e testeve janë të përcaktuara në syllabus me kohë.
2	Test	40		Testi periodik i parë
3	Test	40		Testi periodik i dytë
4	Pjesëmarrja	10		Prezenca dhe aktiviteti i studentit në orë do të vlerësohet

Kushtet e përsëritjes:

Sipas rregullores së Kolegjit Riinvest, studentët obligohen të kalojnë me sukses lëndën brenda 3 afateve të nënshtruara të provimit. Nëse studentët nuk i nënshtrohen provimit të lëndës së caktuar në afatin e dhënë, atëherë llogaritet se kanë shpenzuar afatin dhe mundësinë brenda vitit akademik. Nëse pas 3 mundësive për nënshtrim të provimit brenda një viti akademik, studentët nuk kalojnë lëndën, atëherë ata obligohen të e dëgjojnë sërish lëndën në vitin vijues akademik; Nëse studentët nuk arrijnë që ta kalojnë lëndën në mundësinë e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (detyrat, vlerësimet e kollokviumeve) gjatë ligjëratave ju ruhen deri në afatin e tretë pra afatin shtatorit.

Burimet:

- B. Pira dhe A. Berisha, Matematikë themelore për ekonomiks dhe biznes, Riinvest 2011

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	3	
Ushtrime:	2	
L+U:	75	
Seminar/praktike.:	0	
Studim i vazhdushem:	60	
Pregaditja e Provimit:	75	
Pjesemarrja ne teste:	6	
Pjesemarrja ne provimin final:	3	
Me profesorin dhe asistentin:	6	
Total Ore:	225	
ECTS:	9	